

## **Ballkani: Konfrontim dhe Ngecje**

**Blerim Abedini, Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim- Maqedoni(CSSD)**

**Jeta nën presion ka detyruar popullsinë e Ballkanit gjatë historisë, për të kryer reformat e kushtëzuara nga perandoritë dhe faktorët tjerë gjeopolitikë. Megjithatë, Ballkani nuk është tangjent vetëm e BE-së, por kjo varet nga faktorët tjerë ndërkombëtarë. Maqedonia si një shembull i kontestuar, ka mosmarrëveshje bilaterale me vendet fqinje e përfshirë brenda rekomandimeve të BE-së dhe Aleancës Veri-Atlantike. Shembull tjetër është Serbia, e cila ka ndikime nga shumë faktorë gjeopolitikë, si nga BE, NATO, Rusia dhe Kina.**

Ballkani si arenë e strategjive gjeopolitike është në konfrontim me politikën duale. Gadishulli, ajo e ka të vështirë për të gjykuar drejtë, dhe alarmon statusin e një 'SOS'-i. Kjo gjendje e përfolur shpesh si një gjendje status quo, e cila në vehte është një bartje e evenimenteve, që janë paraardhëse të zhvillimeve historike ndër shekuj. Kjo trysni e ka detyruar popullatën e Ballkanit t'i nënshtrohet reformave që e kushtëzuan perandoritë dhe faktorët tjerë gjeopolitikë, me kusht të vazhdohet ultimativisht me kultivimin e traditave nacionale dhe për një përparim socio-ekonomik.

Praktikat nënshtruese ballkanike janë të ndikuara nga faktorët gjeopolitike që tentojnë të shtrijnë dhe zbatojnë interesin e planifikuar në Lindjen e Afërt. Sot ndëgjojmë disa zëra jo zyrtare, që sqarojnë se BE duhet medoemos të zgjerohet me Ballkanin Perëndimor pa patur parasysht reformat jo të plota. Nga kjo nënkuptohet një dualitet i planifikuar që përfshin konceptin e formimit ose përkufizimit të kufijve të saja gjeografikë dhe krijimin e një Bashkësie të fortë dhe e aftë ti mbroj kufijtë e saja. Bazuar në deklaratat jo zyrtare, Ballkani jo e plotë me rekomandimet reformuese nuk është pengesë për aderimin e saj në familjen evropiane, e cila deklaratë është në kundërshtim me rregullativën e EU-së dhe kërkon ti korrigjoj programet e planifikuara nga BE, si dhe konditat e duhura për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, Ballkani nuk është tangjenta e vetme që udhëhiqet nga BE-ja, por ajo varet nga fuqitë tjera ndër kontinentale. Maqedonia si një shembull mjaft i kontestuar, përmban çështjet bilaterale me shtetet fqinje si rekomandime nga BE-ja dhe Aleanca Veri-Atlantike. Shembull tjetër e kemi Serbinë, e cila ndikohet nga BE-ja, NATO, Rusia dhe Kina, që në të njëjtën rast është një ndikim i faktorëve ndërkombëtarë në Ballkan. Në hemisferën tjetër na paraqitet lufta në Lindjen e Afërt që përngjan një cikloni në galaktikë, e ashtuquajtur 'Black Hole' që i ka neutralizuar liderhipet e rajonit në vendimarrjet e solucionit. Turqia e dekurajuar me politikën e BE dhe disa shteteve të Aleancës Veri-Atlantike, ka vendosur ultimatim për kursin e ri politik në marrëdhëniet ndërkombëtare duke sinjalizuar për bashkpunim me aleancat e reja të kontinentit aziatik. Është për të brengosur se, kaosi politik global i formuar, ka sjellur në pyetje përdorimin e armëve bërthamore.

Me siguri se përgjegjësia për të ardhmen e Botës do ta detyrojë administratën e presidentit Donald Trump, të korrigjojë politikën e njëanshme të BE-së. NATO si duket gradualisht do të frenojë me aktivitetet ushtarake mbrojtëse në Evropë dhe do të duhet të ofroj një strategji të qëndrueshme.

Përfundimisht bashkëpunimi mes aktorëve në luftën siriane do të jetë vendimtare për paqen në Botë. Ngel të shihet se si do të shpërndahen forcat paqeruajtëse në Siri dhe Irak.

Nëse vëzhgojmë Ballkanin si familje e plotë në BE, ballafaqimi me masat e anti korrupsionit që është rekomandimi shumë i arsyetueshëm nga ana e BE-së, dhe njëkohësisht imperativ dhe detyrë e papërbushur i lidershipeve të vendeve Ballkanike. Lajmet nga rajoni tregojnë se korrupsioni në Ballkan është i lartë, ku viktimat si çdo herë paraqiten mediumet raportuese. BE në të ardhmen, si e plotë në kufijtë e saj gjeografike, duhet të revidoj vendimarrjet e saja dhe të ndryshoj politikat e jashtme. Ajo ka potenciale intelektuale por jo edhe pozitë të volitshme gjeostrategjike.

Ngel motoja e përfolur prej kohësh, dhe ajo na thotë që gabimet nga e kaluara nuk duhet të perseriten.

Te grafikonet janë treguar Investimet e huaja direkte në Evropën Juglindore. Investitorët kryesorë janë shtetet që gjinden në Amerikën e Veriut, Bashkimin Evropian dhe Azi.




Figura 1. Hyrjet e mjeteve. Investimet sipas rajoneve dhe ekonomisë, në Evropën Jug-Lindore, 1990-2015. FDI-të në Evropën Juglindore tregojnë përqindje të lartë të investimeve në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor.




Figura 2. Hyrjet e mjeteve, investimet e jashtme direkte sipas rajoneve dhe ekonomisë, në Evropën Jug-Lindore, 1990-2015.

FDI-të në vendet e Ballkanit Perëndimor. Shihen aktivitetet e ulëta të investimeve direkte.